



Shkurt 2023

shqip

Jam i dashur!

Kontakt: Meinolf Wacker
Kirchplatz 7
59174 Kamen

Mobil.: +49-172-5638432
Mail: meinolf.wacker@go4peace.eu
Homepage www.go4peace.eu

**Jezusi e pa dhe
e përqafoi.**

(Mk 10,21)

Të dashur miq të go4peace,

sado i ri apo i vjetër të jesh, grua apo burrë, dëshira për të qënë i dashur është gjithmonë aty! Herë pas here jeta jep momente që e lënë këtë dëshirë të plotësohet thellësisht. Psikologët i quajnë këto momente "përvoja e të qënurit". Një nga këto momente, më është dhënë vite më parë. Unë isha duke ecur në mal me miqtë e mi. Ne ngritëm tendat tona në një lartësi mbi 2500 metra. Gjumi nuk ishte opsion për mua atë natë. U shtriva në një shkëmb të madh me jastëkun tim të gjumit ndërsa qielli me shumë yje shkëlqente mbi mua. Papritur u pushtova aq shumë nga kjo pamje saqë qava. Unë, një njeri i vogël, isha në mes të këtij universi të pafund. Ndjeva jetën time unike. Papritur kuptova: Ti je i kërkuar, i dashur, pafundësisht! Kjo siguri nuk më ka lënë kurrë.

Një i ri në kohët biblike duhet të ketë pasur një përvojë të tillë. Ai i kishte përmbushur të gjitha urdhërimet e ligjit hebre, por kjo nuk i mjaftonte. Uria e tij nuk ishte ngopur ende. Me këtë mall ai erdhi te Jezusi. Sigurisht, Jezusi e dinte menjëherë se çfarë po ndodhte. Ai ndjeu urinë e atij të riu për të qënë i dashur. Jezusi e shikoi dhe e përqafoi.

Kështu funksionon thirrja. Jeta ju perqafon, dhe ju ndjeni se jeni krijuar për diçka të madhe. Ju guxoni dhe veproni. E kisha takuar Julian nga Ukraina. Ajo vinte nga Kherson. Në lot, ajo më kishte thënë se Spitalit Luchansky në qytetin e saj po i mbaronte energjia. Ne kishim organizuar tashmë 9 gjeneratorë. Tregu ishte bosh, por ndjeva: Guxo përsëri! Pas dy orësh kërkime në internet, më erdhi impulsi: Kërko edhe një minutë. Unë qëndrova i sintonizuar. Dhe aty ku Website-i sapo kishte thënë "i shitur" dhe "aktualisht i padisponueshëm", tani gjeta një model me fuqi 7.5 kilovat. Modeli na erdhi disa ditë më vonë. Kur shoferi i kamionit shkarkoi gjeneratorin unë i tregova: "Do e çojmë në Kherson të Ukrainës!". Ai më goditi në supe me lot në sy dhe më tha: "Kjo ma bëri ditën! Faleminderit për angazhimin tuaj ndaj njerëzimit. Unë jam libanez dhe e di se çfarë do të thotë të marrësh ndihmë!" Në atë moment u ndjeva përsëri i dashur thellësisht, i përqaftuar nga jeta, i përqaftuar nga Zoti. Besoni në të: Jeta gjithashtu dëshiron t'ju përqafojë dhe t'ju tregojë **Jam i dashur** – pafundësisht i dashur!

për go4peace-Team

Meinolf Wacker